



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 25.3.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI - SHQIPËRI, ALOKIMET E VITIT 2017”

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 25 mars 2019, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri, alokimet e vitit 2017. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Blerina Gjylameti.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin për shqyrtim në Kuvend mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Marrëveshja është nënshkruar në dhjetor 2018. Ajo ka qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ndërkufitare që lidhin Shqipërinë me Malin e Zi, nëpërmjet projekteve të përbashkëta, shkëmbimit të përvojës dhe njohurive, si dhe përmirësimit të politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale e lokale në zonën ndërkufitare.

Kjo marrëveshje parashikon financimin nga:

- Granti i Bashkimit Europian nëpërmjet instrumentit IPA II, në vlerën 1.19 milionë euro për të dyja shtetet;
- Bashkëfinancimi kombëtar prej 210 mijë eurosh nga të dyja shtetet.

Ky financim do të mbulojë alokimet e vitit 2017 dhe do të përdoret në këto fusha prioritare:

- Nxitjen e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore e natyrore;
- Mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e përshtatjes dhe të lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- Nxitjen e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe të përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Zonat shqiptare që do të përfitojnë nga kjo marrëveshje janë Shkodra, Lezha dhe Tropoja.

Marrëveshja është pjesë e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri 2014-2020, i cili parashikon dhënien e një kontributi financiar nga BE prej 11.9 milionë eurosh, si dhe një kontribut të shteteve pjesëmarrëse, për të nxitur bashkëpunimin dhe zhvillimin social e ekonomik rajonal, forcimin institucional dhe avancimin e reformave përgatitore për anëtarësim në BE.

Deri tani janë ratifikuar tri marrëveshje financimi në kuadër të këtij programi, të cilat parashikojnë financimet përkatëse për alokimet e viteve 2014, 2015 dhe 2016.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja paraqiti projektligjin, duke u ndalur në rolin që ai do të luajë në zhvillimin ekonomik e social të zonave që do të mbështeten nga marrëveshja. Anëtarët e Komisionit mbështetën mendimin e paraqitur nga relatorja.

- ***Përfundim.***

Si konkluzion, Komisioni është i mendimit se marrëveshja është me rëndësi të veçantë, pasi do të sigurojë mbështetje financiare për zhvillimin e disa zonave të vendit që janë në kufi me Malin e Zi. Ajo do të kontribuojë në zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e punësimit në këto zona. Për këto arsye, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Arben AHMETAJ